

30 Qershor 2021

NJOFTIM PËR SHPREHJE INTERESI PËR ANËTARËSIM NË KODIN E STANDARDEVE PËR ORGANIZATAT JOFITIMPRURËSE NË SHQIPËRI

Anëtarësia në Kodin e Standardeve është e hapur për të gjithë organizatat e shoqërisë civile të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

OJF-të e interesuara për t'u anëtarësuar në Kod mund të shprehin interesin e tyre duke plotësuar dhe dërguar në mënyrë elektronike dokumentat si më poshtë:

1. Letër shprehje interesi
2. Kornizën Vet-Vlerësuese të Kodit të Standardeve të plotësuar
3. Dokumentacionin mbështetës/dëshmues në përmbushje të treguesve të Kornizës Vet-Vlerësuese. Dokumentet dëshmuese mund të shoqërohen me një relacion shpjegues për çdo tregues.

Ftojme të gjitha organizatat e interesuara të dërgojnë shprehjen e interesit dhe dokumentat shoqëruese si më lart në çdo kohë, në adresën info@resourcecentre.al

Afati i fundit për dërgimin e shprehjeve të interesit **për këtë raund anëtarësimi** është më datë **26 Shtator 2021**.

Shprehjet e interesit pas kësaj date, do të shqyrtohen në mbledhjen në vijim.

Kriteret e anëtarësimit në KS dhe vlerësimi i aplikimit

Anëtar i Kodit mund të jetë çdo OJF që ka shprehur interes dhe që si pjesë e procesit të vlerësimit ka marrë jo më pak se 40% të totalit të pikëve për secilin nga 7 angazhimet e KS. Për më shumë referoju [Kornizës Vet-Vlerësuese](#).

Vlerësimi i aplikimit dhe nivelit të përmbushjes së detyrimeve dhe kërkesave bazë, do të kryhet nga Komiteti i Kodit.

Vendimmarrja mbi procesin e vlerësimit të shprehjeve të interesit të dërguara deri në 15 Shtator 2021, do të kryhet në mbledhjen më të afërt të Komitetit në muajin Tetor 2021.

Për më shumë informacion rreth Kodit të Standardeve për OJF-të në Shqipëri [lexoni këtu](#).